



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.12

19 shkurt

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.79, datë 21.1.2009	Për miratimin e stemës, të uniformës, gradave, emblemës, flamurit dhe shenjave të Policisë së Shtetit	901
Vendim i KM nr.80, datë 21.1.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.646, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit”	903
Vendim i KM nr.81, datë 27.1.2009	Për shpalljen e zonës ekonomike në Lezhë dhe përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të kësaj zone	904
Vendim i KM nr.83, datë 27.1.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar	910
Vendim i KM nr.84, datë 27.1.2009	Për caktimin e kritereve për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit	911
Vendim i KM nr.85, datë 21.1.2009	Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së ngastrave, të ekonomisë pyjore “Lugina e Fanit të Madh”, Mirditë, që do të përdoret nga “Gruppo Minerario Albanese” sh.p.k., për karriera bazaltesh	913
Vendim i KM nr.86, datë 27.1.2009	Për shpërblimin e familjeve të fshatit Levrushk, komuna Qelëz, rrethi Pukë, për dëmin që u është shkaktuar nga prania e hidrocentralit të Komanit	916
Vendim i KM nr.87, datë 27.1.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, që preket nga zgjerimi i varrezave publike në bashkinë e Fierit	918
Vendim i KM	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të	

nr.89, datë 27.1.2009	Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen për marrëdhëniet ekonomike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë	919
Vendim i KM nr.92, datë 27.1.2009	Për kalimin e përgjegjesisë së administrimit të kinoklubit “Studenti” nga “Trajtimi i studentëve, nr.1”, sh.a., Tiranë, Universitetit të Tiranës, për Fakultetin e Drejtësisë	920
Vendim i KM nr.94, datë 21.1.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për kryerjen e studimit për ullirin	921
Vendim i KM nr.95, datë 27.1.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga zgjerimi i rrugës dhe i trotuarëve, në rrugën “11 Nëntori”, në bashkinë e Elbasanit	922
Vendim i KM nr.96, datë 27.1.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në shkollën e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti””	923
Vendim i KM nr.97, datë 27.1.2009	Për hapjen e programit të studimit, “Master i nivelit të parë”, për përcaktimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimi, në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, në vitin akademik 2008-2009	924
Vendim i KM nr.99, datë 27.1.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin e portit të kontenierëve, në pyllin e sodës, Vlorë, si dhe për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	925
Vendim i KM nr.108, datë 27.1.2009	Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda, në pyje...	925
Vendim i KM nr.109, datë 27.1.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	926
Vendim i KM nr.110, datë 27.1.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të një automjeti dhe dy trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	927
Vendim i KM nr.111, datë 27.1.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane dhe të një automjeti e dy trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	928
Vendim i KM nr.112, datë 21.1.2009	Për dhënien e lejes shoqërisë “Trans European Energy BV”, sh.a., për ndërtimin dhe përdorimin e terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL), në parkun energjetik në bregdetin e qarkut të Fierit, të gazsjellësit nëndetar Shqipëri-Itali, si dhe të rrjetit të gazit, në territorin shqiptar	929
Vendim i KM nr.115, datë 2.2.2009	Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, në disa ministri dhe institucione qendrore	929
Vendim i KM nr.145, datë 11.2.2009	Për transferimin e paketës së aksioneve të zotëruara nga shteti në “Albtelecom”, sh.a. Tiranë.....	932

Udhëzim i METE
nr.69, datë 29.1.2009

Për procedurat e likuidimit të shoqërive shtetërore 932

Vendim i GJK
nr.3, datë 2.2.2009

Me objekt 1. Shpallja si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kartën Europiane të Autonomisë Vendore të neneve 3, pika 8; 4; 5, pika 2; 6; 7; 8; 10; 13; 14, pika 3; 16; 17; 20, pika 2; 23; 24; 26 dhe 28, pika 2, të ligjit nr. 9895, datë 9.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr9895, datë 9.6.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.... 934

VENDIM
Nr.79, datë 21.1.2009

**PËR MIRATIMIN E STEMËS, TË UNIFORMËS, GRADAVE, EMBLEMËS, FLAMURIT
DHE SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 38 e 69 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e stemës, të uniformës, gradave, emblemës, flamurit, stemave të shërbimeve dhe të shenjave të Policisë së Shtetit, sipas albumit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Stema, uniformat, emblemat, gradat, flamuri dhe shenjat e Policisë së Shtetit do të jenë, si më poshtë vijon:

2.1 Stema e Policisë së Shtetit përbëhet nga shqiponja dykrenare, e njëjtë me atë të Flamurit Kombëtar, nga përkrenarja e Heroit Kombëtar “Gjergj Kastriot Skënderbeut”, dhe harta e Shqipërisë. Sfondi është me ngjyrë të kuqe. Në pjesën e poshtme vendoset fjala “POLICIA”, e shkruar me ngjyrë të bardhë, në një sfond blu të errët.

2.2. Stemat, sipas shërbimeve të policisë, do të jenë:

2.2.1. Stema e departamentit të kufirit dhe migracionit: Në pjesën e sipërme vendoset fjala “POLICIA”, e shkruar me ngjyrë të bardhë, në një sfond të kuq, ndërsa në pjesën e poshtme shënohen “KUFIRI E MIGRACIONI”, me ngjyrë të bardhë, në një sfond blu të errët. Në mes janë vendosur harta e Shqipërisë dhe elemente të mjeteve lundruese ajrore dhe tokësore. Sfondi është blu i errët.

2.2.2 Stema e policisë së rendit: Në pjesën e sipërme shkruhet fjala “POLICIA”, me ngjyrë të bardhë, në një sfond të kuq, ndërsa në pjesën e poshtme fjala “RENDIT”, e shkruar me ngjyrë të bardhë, në një sfond blu të errët. Në mes është disenjuar një grusht, i cili ka shtrënguar një vetëtimë. Sfondi është në ngjyrë blu të errët.

2.2.3. Stema e policisë rrugore: Në pjesën e sipërme shkruhet fjala “POLICIA”, me ngjyrë të bardhë, në një sfond të kuq, ndërsa në pjesën e poshtme fjala “RRUGORE”, e shkruar me ngjyrë të bardhë, në një sfond blu të errët. Në mes është disenjuar harta e Shqipërisë, me kalin fluturues me hark. Sfondi është në ngjyrë blu të errët..

2.2.4. Stema e forcave speciale: Në pjesën e sipërme shkruhet fjala “POLICIA”, me ngjyrë të bardhë, në një sfond të kuq, ndërsa në pjesën e poshtme fjala “FORCA SPECIALE”, me ngjyrë të bardhë, në një sfond blu të errët. Në mes është disenjuar simboli i vetëtimës, në mesin e dy krahëve të shqiponjës. Sfondi është në ngjyrë blu të errët.

2.2.5. Stema e FNSH-së: Në pjesën e sipërme shkruhet fjala “POLICIA”, me ngjyrë të bardhë, në një sfond të kuq, ndërsa në pjesën e poshtme inicialet “FNSH”, me ngjyrë të bardhë, në një sfond blu të errët. Në mes është disenjuar një shqiponjë, me një shigjetë, në ngjyrë ari, e cila është vendosur në një sfond me ngjyrë të errët.

2.2.6. Logoja e policisë: Në pjesën e sipërme është shkruar “POLICIA”, me ngjyrë të artë, në një sfond të kuq, poshtë është vendosur stema e Republikës, në një sfond blu të errët. Konturimi është me shirit me ngjyrë të kuqe.

2.3 Uniformat: Në përdorim të punonjësve të Policisë së Shtetit do të jenë uniformat dhe veshjet e mëposhtme:

- Uniforma ceremoniale;
- Uniforma bazë operacionale;
- Uniforma e stërvitjes;
- Uniforma për shërbimet e veçanta;
- Veshja civile, që kompensohet në vlerë.

2.4. Emblema: Vendoset në pjesën ballore të kapelës dhe përbëhet nga shqiponja dykrenare, e njëjtë me atë të Flamurit Kombëtar, e modeluar me dy kallëza gruri, me ngjyrë të artë.

2.5. Gradat, sipas niveleve në Policinë e Shtetit, do të jenë:

2.5.1. Gradat për punonjës policie, të nivelit zbatues:

Gradat e nivelit zbatues të jenë me fushë në ngjyrë të zezë, me pesëkëndësh në ngjyrë të

argjendte, të vendosur mbi të, me konturim me shirit në ngjyrë të argjendte, ku ndryshimi do të përcaktohet nga numri i pesëkëndëshave, sipas gradave, brenda nivelit. Për gradën “Nëninspektor”, një pesëkëndësh, për gradën “Inspektor”, dy pesëkëndësha, dhe për gradën “Kryeinspektor”, tri pesëkëndësha.

2.5.2. Gradat për punonjës policie, të nivelit të parë drejtues:

Gradat e nivelit të parë drejtues të jenë me fushë në ngjyrë blu të errët, me yje në ngjyrë të argjendte, të vendosura mbi të, me konturim me shirit në ngjyrë të argjendte, ku ndryshimi do të përcaktohet nga numri i yjeve, sipas gradave, brenda nivelit. Për gradën “Nënkomisar” një yll, për gradën “Komisar” dy yje dhe gradën “Kryekomisar” tri yje.

2.5.3. Gradat për punonjës policie, të nivelit të mesëm drejtues:

Gradat e nivelit të mesëm drejtues të jenë me fushë në ngjyrë blu të errët, me emblemën e Policisë së Shtetit, në ngjyrë të artë, të vendosur mbi të, me konturim me shirit në ngjyrë të artë, me yje në ngjyrë të artë, ku ndryshimi do të përcaktohet nga numri i yjeve, sipas gradave, brenda nivelit, ku grada “Drejtues” ka një yll dhe grada “Drejtues i parë” ka dy yje.

2.5.4. Gradat për punonjës policie, të nivelit të lartë drejtues:

Gradat për nivelin e lartë drejtues të jenë me fushë në ngjyrë të argjendte, me emblemën e Policisë së Shtetit, në ngjyrë të artë, të vendosur mbi të, me konturim me shirit në ngjyrë të artë, me yje në ngjyrë të artë, ku ndryshimi do të përcaktohet nga numri i yjeve, sipas gradave, brenda nivelit, ku grada “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm” ka një yll dhe grada “Drejtor i Përgjithshëm” ka dy yje.

2.6. Shenjat dhe elemente të tjera, që përdoren nga policia janë:

2.6.1. Distinktivi i identifikimit të punonjësit të policisë, i cili përbëhet nga logoja e policisë, ku vendoset stema e Republikës, në një sfond të kuq, fjala “POLICIA”, në pjesën e sipërme, e shkruar me ngjyrë të artë, në një sfond blu, me konturim me shirit me ngjyrë të artë.

2.6.2. Shenja e mbiemrit, përmban logon e policisë, mbiemrin, të shkruar me ngjyrë të bardhë, në një sfond blu të errët, me konturim me shirit në ngjyrë të kuqe.

3. Flamuri i Policisë së Shtetit:

3.1. Pjesa valëvitëse e flamurit:

Përbëhet nga një copë mëndafshi, me përmasa 140x100 cm, gjysma e së cilës është me ngjyrë të kuqe dhe gjysma tjetër me ngjyrë blu e ndarë në pjesë të barabarta. Në mes të flamurit është e vendosur shqiponja, e njëjtë me atë të Flamurit Kombëtar. Shqiponja në gjysmën e pjesës blu është me ngjyrë të kuqe, ndërsa ajo në pjesën e kuqe, me ngjyrë të zezë. Flamuri konturohet nga një shirit në ngjyrë të artë.

3.2. Pjesa jovalëvitëse e flamurit:

Përbëhet nga një shtizë cilindrike, me majë, me ngjyrë të argjendte.

4. Uniformat, stema, emblema, flamuri, gradat dhe stemat e shërbimeve të Policisë së Shtetit, për nga qëllimi i përdorimit, i përkasin vetëm strukturës së Policisë së Shtetit. Ndalohet shumëfishimi dhe imitimi i tyre nga institucionet apo subjektet e tjera, që, sipas ligjit, përdorin uniformë.

5. Vendimet nr.332, datë 2.6.1998 “Për miratimin e uniformës dhe të stemës së policisë”, nr.592, datë 2.11.2000 “Për miratimin e flamurit dhe stemës së Policisë së Shtetit” dhe nr.236, datë 23.4.2004 “Për miratimin e uniformës dhe të shenjave të Policisë së Shtetit” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, e në vazhdim, miratuar për Policinë e Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.80, datë 21.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.646, DATË 30.9.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË POLICISË
SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.646, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.2, e përmendur në pikën 2, shfuqizohet.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Numri limit i punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, (më poshtë PMNZSH), në qarqe, të jetë gjithsej, 689 vetë.”.

3. Në lidhjen nr.3, të përmendur në pikën 2, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Tiranë 1 (21 dhjetori), numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 26 vetë.

b) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Kavajë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 11 vetë.

c) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Durrës, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.

ç) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Fier, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 21 vetë.

d) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Berat, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 23 vetë.

dh) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Vlorë nr.1, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 20 vetë.

e) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Gjirokastrë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.

ë) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Korçë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.

f) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Elbasan, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.

g) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Lezhë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 11 vetë.

gj) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Shkodër, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 22 vetë.

h) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Peshkopi, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 14 vetë.

4. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.81, datë 27.1.2009

PËR SHPALLJEN E ZONËS EKONOMIKE NË LEZHË DHE PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË ZHVILLUESIT TË KËSAJ ZONE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, dhe të neneve 4, pika 1, shkronja “g”, e 5, pikat 1 e 3

të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Park industrial”, të territorit, pjesë e zonës kadastrale nr.2660, në Lezhë, në përbërje të së cilës janë parcelat me numër pasurie, sipas dokumentacionit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Sipërfaqja 54.3 (pesëdhjetë e katër pjesë tre) ha, shtrirja dhe kufizimet e saj specifikohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e veprimtarisë, që do të zhvillohen në këtë zonë, janë:

-Veprimtari prodhuese, industriale dhe agropërpunim;

-Veprimtari tregtare, import-eksport;

-Shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.

5. Zona ekonomike jepet me koncesion.

6.Procedura e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës të bëhet në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

7. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, të jetë bashkia Lezhë.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Numri i pasurisë	Volumi	Faqe	Sipërfaqja	Lloji i pasurisë	Pronari
1680	7	155	6423	Arë	Shtet
2292	10	12	21343	Arë	Shtet
2770	11	240	2325	Arë	Shtet
2777	11	247	1955	Arë	Shtet
2778/1	13	96	3287	Arë	Shtet
2778/2	13	97	4432	Arë	Shtet
2779	11	249	832	Arë	Lazer Doda
2780/1	13	93	2465	Arë	Arben Doda
2780/2	13	94	2465	Arë	Gjergj Doda
2780/3	13	95	239	Arë	Arben Doda + B
2781/1	13	98	1587	Arë	Lazer Doda
2781/2	13	99	246	Arë	Shtet
2782/1	13	100	694	Arë	Lazer Doda
2782/2	13	101	321	Arë	Shtet
2783	12	3	1304	Arë	Shtet
2785	12	5	2949	Arë	Shtet
2786	12	6	2231	Arë	Shtet
2787	12	7	1424	Arë	Shtet
2788	12	8	1479	Arë	Shtet
2789	12	9	2279	Arë	Shtet
2790	12	10	2514	Arë	Shtet
2791	12	11	3064	Arë	Shtet
2792	12	12	2283	Arë	Shtet
2793	12	13	8036	Arë	Shtet
2794	12	14	3962	Arë	Shtet

2795	12	15	4714	Arë	Shtet
2796	12	16	4009	Arë	Shtet
2798	12	18	638	Arë	Shtet
2799	12	19	1311	Arë	Shtet
2800	12	20	4757	Arë	Shtet
2801	12	21	3214	Arë	Shtet
2805	12	25	15029	Arë	Shtet
2806	12	26	2165	Arë	Shtet
2879	12	99	4277	Arë	Shtet
2881	12	101	2631	Arë	Shtet
2885	12	105	1326	Arë	Shtet
2886	12	106	1127	Arë	Shtet
2889	12	109	2331	Arë	Shtet
2890	12	110	2013	Arë	Shtet
2891	12	111	1569	Arë	Shtet
2892	12	112	1598	Arë	Shtet
2893	12	113	2206	Arë	Shtet
2894	12	114	1744	Arë	Shtet
2895	12	115	45552	Arë	Shtet
2896	12	116	2829	Arë	Shtet
2897	12	117	3127	Arë	Shtet
2898	12	118	2842	Arë	Shtet
2899	12	119	2991	Arë	Shtet
2900	12	120	1699	Arë	Shtet
2901	12	121	1797	Arë	Shtet
2903	12	123	2700	Arë	Shtet
2904	12	124	5724	Arë	Shtet
2905	12	125	1991	Arë	Arben Deda
2906	12	126	3104	Arë	Shtet
2907	12	127	7172	Arë	Shtet
2908	12	128	785	Arë	Shtet
2909	12	129	850	Arë	Shtet
2910	12	130	7675	Arë	Shtet
2911	12	131	7589	Arë	Shtet
2912	12	132	3250	Arë	Shtet
2913	12	133	273	Arë	Shtet
2914	12	134	309	Shesh	Shtet
2915	12	135	357	Shesh	Shtet
2916	12	136	300	Shesh	Shtet
2917	12	137	2183	Livadh	Shtet
2918	12	138	313	Shesh	Shtet
2919	12	139	1702	Livadh	Shtet
2920	12	140	2211	Rrugë	Shtet
2921	12	141	727	Arë	Shtet
2922	12	142	592	Truall	Shtet
2923	12	143	527	Arë	Llesh Teta
2924	12	144	2074	Shesh	Shtet
2926	12	145	80	Shesh	Shtet
2927	12	146	1863	Rrugë	Shtet
2928	12	147	762	Arë	Shtet
2929	12	148	1709	Ledh	Shtet
2930	12	149	2154	Arë	Shtet
2931	12	150	2484	Arë	Shtet

2932	12	151	3786	Arë	Gjin Teta
2933	12	152	6544	Karrier	Shtet
2934	12	154	993	Karrier	Shtet
2935	12	155	2244	Karrier	Shtet
2936	12	156	1442	Arë	Shtet
2937	12	157	133	Truall	Shtet
2938	12	158	1385	Shesh	Shtet
2939	12	159	1226	Kanal	Shtet
2940	12	160	1969	Arë	Shtet
2941	12	161	1651	Arë	Shtet
2942/1	13	75	1970	Arë	Shtet
2942/2	13	76	1970	Arë	Lek Zef Dedgjonaj
2943	12	163	2245	Arë	Shtet
2944	12	164	611	Kanal	Shtet
2945	12	165	249	Arë	Lek Zef Dedgjonaj
2946	12	166	3361	Arë	Shtet
2947	12	167	1585	Arë	Shtet
2948	12	168	1205	Arë	Shtet
2949	12	169	2827	Arë	Shtet
2950	12	170	251	Truall	Gjin Zef Lleshi
2954	12	174	3163	Arë	Shtet
2955	12	175	249	Truall	Lazer Zef Simoni
2956/1	13	77	1023	Arë	Shtet
2956/2	13	78	1410	Arë	Simon Zef Dedgjonaj
2957/1	13	79	371	Arë	Shtet
2957/2	13	80	488	Arë	Simon Zef Dedgjonaj
2958/1	13	81	1374	Arë	Shtet
2958/2	13	82	1307	Arë	Simon Zef Dedgjonaj
2959	12	179	923	Ledh	Shtet
2960	12	180	17223	Kënetë	Shtet
2961	12	181	5992	Kënetë	Shtet
2962	12	182	250	Kënetë	Pjetër Preng Kola
2963	12	183	2452	Arë	Shtet
2964	12	184	1074	Arë	Shtet
2965	12	185	250	Arë	Gjergj Preng Kola
2966	12	186	670	Pemtore	Shtet
2967	12	187	1740	Pemtore	Shtet
2968	12	188	164	Ledh	Shtet
2969	12	189	250	Ledh	Mark Preng Kola
2970	12	190	250	Ledh	Mark Preng Kola
2971	12	191	774	Pemtore	Shtet
2972	12	192	205	Varreza	Shtet
2973	12	193	82	Truall	Shtet
2974	12	194	196	Truall	Shtet
2975	12	195	2828	Ledh	Shtet
2976	12	196	638	Ledh	Shtet
2977	12	197	655	Ledh	Preng Dod Shahini
2978	12	198	2509	Ledh	Gjergj Geg Shahini
2979	12	199	2451	Ledh	Zef Pal Shahini
2980	12	200	2246	Arë	Shtet
2982	12	202	939	Arë	Shtet
2983	12	203	3550	Karriere	Shtet
2984	12	204	744	Karriere	Shtet

2985	12	205	596	Pemtore	Shtet
2986	12	206	1707	Arë	Shtet
2987	12	207	936	Arë	Shtet
2988	12	208	250	Arë	Lek Geg Shahini
2989	12	209	300	Arë	Ded Kol Shahini
2990	12	210	1351	Arë	Shtet
2991	12	211	677	Ledh	Shtet
2992	12	213	2142	Shesh	Shtet
2993	12	213	569	Truall	Shtet
2994	12	214	414	Shesh	Shtet
2996	12	216	1145	Arë	Shtet
2997	12	217	1705	Arë	Shtet
2998	12	218	2239	Arë	Shtet
2999	12	219	2066	Arë	Shtet
3000	12	220	1152	Ledh	Shtet
3001	12	221	1752	Arë	Shtet
3002	12	222	250	Truall	Gjeto Mark Marku
3003	12	223	5093	Arë	Shtet
3004	12	224	1554	Arë	Shtet
3005	12	225	401	Truall	Shtet
3006	12	226	51	Depo uji	Shtet
3007	12	227	542	Arë	Shtet
3008	12	228	4335	Arë	Shtet
3009	12	229	1626	Ledh	Shtet
3010	12	230	1488	Arë	Shtet
3011	12	231	2029	Arë	Shtet
3012	12	232	250	Truall	Gjon Ded Gjoni
3013	12	233	3088	Arë	Shtet
3014	12	234	3389	Arë	Shtet
3015	12	235	12080	Kënetë	Shtet
3016	12	236	1542	Kënetë	Shtet
3017	12	237	14637	Kënetë	Shtet
3018	12	238	52297	Rrugë	Shtet
3019	12	239	2686	Rrugë	Shtet
3020	12	240	2044	Arë	Shtet
3021	12	241	2048	Ledh	Shtet
3022	12	242	250	Truall	Ndue Pal Prendi
3023	12	243	250	Truall	Paulin Ndue Prendi
3024	12	244	375	Rrugë	Shtet
3025	12	245	1749	Rrugë	Shtet
3026	12	246	8274	Kanal	Shtet
3027	12	247	989	Ledh	Shtet
3028	12	248	1754	Ledh	Shtet
3029	12	249	1017	Arë	Shtet
3030	12	250	6098	Kanal	Shtet
3033	13	3	939	Rrugë	Shtet
3034	13	4	5586	Kanal	Shtet
3035	13	5	1664	Arë	Shtet
3036	13	6	314	Arë	Shtet
3037	13	7	170	Arë	Shtet
3038	13	8	118	Ledh	Shtet
3039	13	9	92	Kanal	Shtet
3040	13	10	299	Ledh	Shtet

3041	13	11	266	Ledh	Shtet
3042	13	12	1417	Arë	Shtet
3043	13	13	90	Ledh	Shtet
3044	13	14	571	Kanal	Shtet
3048	13	18	583	Arë	Shtet
3049	13	19	164	Arë	Shtet
3050	13	20	420	Rrugë	Shtet
3051/1	13	85	40	Arë	Shtet
3051/2	13	83	2030	Arë	Nadir Sulejmani
3051/3	13	84	575	Arë	Shtet
3055	13	25	224	Arë	Shtet
3059	13	29	3672	Arë	Shtet
3061	13	31	1250	Arë	Nadir Sulejmani
3062/1	13	33	1173	Arë	Shtet
3062/2	13	34	1500	Arë	Pashk Margjoni
3062/3	13	35	1000	Arë	Shtet
3062/4	13	36	1000	Arë	Shtet
3062/5	13	37	1000	Arë	Shtet
3071	13	71	5200	Arë	Maltin Dedgjoni
3072	13	72	5228	Arë	Lek Dedgjoni

KOMUNA
FSHATZ
CEKAJ

K - 34
SHK. 1:10 000

SIPERFAQJA E PARCELES NR 94/a = 5.4 h
SIPERFAQJA E PARCELES NR 94/b = 3.9 h
SIPERFAQJA E PARCELES NR 95 = 5.1 h



VENDIM
Nr.83, datë 27.1.2009

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.478, datë 19.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “a” të pikës 1, të shtohen fjalët “...dhe nëpunësit civilë, në pozicione mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”.

b) Pas pikës 5/5 shtohet pika 5/6, me këtë përmbajtje:

“5/6. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë, në pozicionet mbështetëse “Specialist”, “Shef seksioni” dhe “Përgjegjës/Shef sektori”, në drejtorinë e policisë, në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome të jenë sipas lidhjes nr.4/56, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Në pikat 6,7,8,9 dhe 13, pas “...4/5” të shtohet edhe “...nr.4/6.”.

ç) Pas pikës 14/1 shtohet pika 14/2, me këtë përmbajtje:

“14/2.Struktura dhe nivelet e pagave, të përcaktuara për nëpunësit civilë të sistemit të Policisë së Shtetit, sipas këtij vendimi, zbatohen, rast pas rasti, pas kalimit të punonjësve nga funksione me kompetenca policore në funksione të shërbimeve mbështetëse, kur përshkrimi i punës për këto funksione nuk kërkon kompetenca policore, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 66 të vendimit nr.805, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit.”.

2. Nëpunësit ekzistues të sistemit të Policisë së Shtetit, të cilët, si rezultat i këtij vendimi, pësojnë rënie page, ruajnë nivelin e pagës, që përfitonin përpara se funksionet/pozicionet e tyre të kalonin në pozicione të shërbimeve mbështetëse, pa funksione policore.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për sistemin e Ministrisë së Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.4/6

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË POZICIONET MBËSHTETËSE “SPECIALIST”, “SHEF SEKSIONI” DHE “PËRGJEGJËS/SHEF SEKTORI”, NË DREJTORITË E POLICISË NË QARQE, KOMISARIATE DHE REPARTE AUTONOME

POZICIONI	KATEGORI A	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	
Përgjegjës/Shef sektori në drejtorinë e policisë së qarkut	III-b	11 000	2%		51 500
Shef seksioni në drejtoritë e policisë së qarkut, komisariate apo reparte autonome	IV-a	11 000	2%		39 000
Specialist	IV-b	11 000	2%		29 000
	IV-c	11.000	2%		21 500

**VENDIM
Nr.84, datë 27.1.2009**

PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR NGRITJEN E RRJETIT TË INVENTARIZIMIT DHE TË MONITORIMIT TË BIODIVERSITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 9 të ligjit nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit, në shërbim të sigurimit të bazës së të dhënave, për hartimin e politikës në mbrojtje të biodiversitetit.
2. Në kuptim të këtij vendimi:
 - a) Inventarizimi është vëzhgimi, përzgjedhja, katalogimi, përcaktimi sasior dhe hartografimi i përbërësve të biodiversitetit, si dhe sinteza e informacioneve rezultuese për analizën e procesit.
 - b) Monitorimi i biodiversitetit është matja, e standardizuar dhe periodike, e një grupi, të kufizuar dhe të veçantë, të treguesve të biodiversitetit, në zona ose stacione të veçanta, të përzgjedhura për këtë qëllim.
3. Rrjeti i informatizimit dhe monitorimit të biodiversitetit ngrihet dhe funksionon, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - a) Të garantojë monitorim afatgjatë të biodiversitetit;
 - b) Të sigurojë zbatimin e legjislacionit vendas, për mbrojtjen e biodiversitetit, si dhe të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë;
 - c) Të mundësojë sistemimin e të dhënave në një format të përdorshëm nga vendimmarrësit;
 - ç) Të ofrojë informim për biodiversitetin, për ndërgjegjësimin e publikut për ruajtjen e biodiversitetit;
 - d) Të krijojë një sistem informacioni, për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave për biodiversitetin, në përputhje me standardet e vendeve të BE-së;
 - dh) Të ndërtojë një sistem inventarizimi dhe monitorimi me kosto të ulët;
 - e) Të ketë një strukturë fleksibël, që, në përputhje me nevojat për raportim, të rishihet çdo vit.

- e) Të sigurojë trajnimin e specialistëve të rinj, për monitorimin e biodiversitetit.
4. Rrjeti i inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit ka për detyrë:
- a) Të identifikojë përbërësit e biodiversitetit, në kushtet in-situ dhe ex-situ;
- b) Të krijojë treguesit dhe të përcaktojë mënyrat përkatëse, për mbledhjen, shpeshhtësinë, analizën dhe raportimin e të dhënave;
- c) Të monitorojë sistematikisht përbërësit e biodiversitetit, të identifikojë proceset dhe kategoritë e veprimtarive, si dhe shkaqet, që kanë ose mund të kenë ndikime negative në ruajtjen e përdorimin e qendrueshëm të biodiversitetit, me ndihmën e metodologjive shkencore, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- ç) Të përmbledhë gjendjen dhe prirjet, për përbërësit e identifikuar të biodiversitetit;
- d) Të identifikojë boshllëqet në njohuritë e deritanishme dhe të ndërmarrë kërkime, për t'i plotësuar ato;
- dh) Të plotësojë nevojat për kërkime, për inventarizimin dhe monitorimin, të specifikuar në strategjinë dhe planin e veprimit të biodiversitetit, në planet dhe regjistrat, e specifikuar në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
- e) Të mbështesë kërkesat për raportim, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ë) Të kryejë vlerësimin dhe analizën e gjendjes së biodiversitetit, të ndikimeve të faktorit njerëzor dhe të masave, për të parandaluar humbjet e tij;
- f) Të shërbejë si instrument, për të vlerësuar përmbushjen e angazhimeve të vendit tonë, në kuadër të konventës së biodiversitetit dhe të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, ku vendi ynë është palë, si dhe të shërbejë për raportim tek institucionet përkatëse europiane dhe botërore;
- g) Të funksionojë si një sistem paralajmërimi i shpejtë për proceset dhe prirjet, që rrjedhin nga humbja e biodiversitetit;
- gj) Të ofrojë informacion për gjendjen e biodiversitetit, në një format të përshtatshëm për përdorim nga publiku i gjerë.
5. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, e cila ngarkohet me ngritjen dhe administrimin e rrjetit, ka për detyrë:
- a) që, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore, universitetet dhe qendrat shkencore, të specializuara në fushën e biodiversitetit, si dhe me organet e qeverisjes vendore, për pyjet dhe kullotat komunale, të hartojë, brenda gjashtëmuorit të parë të vitit paraardhës, projektprogramin e vitit pasardhës, për ngritjen dhe administrimin e rrjetit, duke u përqendruar në çështjet e mëposhtme:
- i) në përcaktimin e pikave konkrete të rrjetit;
- ii) në përcaktimin e institucioneve, që do të marrin pjesë në rrjet;
- iii) në përcaktimin e treguesve të biodiversitetit dhe të buxhetit përkatës;
- iv) në planifikimin për sistemin e informacionit, për mbledhjen e të dhënave, administrimin, analizën, raportimin dhe shpërndarjen e tyre.
- b) Miratimin e projektprogramit të hartuar nga kjo agjenci nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në përputhje me kufijtë e Buxhetit të Shtetit, afatet dhe kërkesat për përgatitjen e zbatimit e programit vjetor të monitorimit të mjedisit dhe rezultatet e monitorimit paraardhës.
5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.85, datë 21.1.2009

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES SË NGASTRAVE, TË EKONOMISË
PYJORE “LUGINA E FANIT TË MADH”, MIRDITË, QË DO TË PËRDORET NGA
“GRUPPO MINERARIO ALBANESE” SHPK, PËR KARRIERA BAZALTESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2007 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të

912

Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet e ngastrave 94/a, 94/b e 95 të ekonomisë pyjore “Lugina e Fanit të Madh”, Mirditë, që do të përdoren nga “Gruppo Minerario Albanese” sh.p.k., për karriera bazaltesh, me sipërfaqe, gjithsej, 14.4 (katërbëdhjetë pikë katër) ha, të hiqen nga fondi pyjor dhe nga kadastra kombëtare e pyjeve, sipas tabelës nr.1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në harta kufij të rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëjë çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll”, dhe ta regjistrojë në sipërfaqe inproduktive (karrierë bazaltesh), në përputhje me pikën 9 të vendimit nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.

3. Vlera e kësaj sipërfaqeje pyjore të paguhet nga “Gruppo Minerario Albanese” sh.p.k. para hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Llogaritja e tarifave për heqjen nga fondi pyjor të bëhet sipas lidhjes 4 të vendimit nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, “Gruppo Minerario Albanese” sh.p.k., të pyllëzojë, përpara se të fillojë veprimtarinë, me fondet e veta, 15 (pesëmbëdhjetë) ha, me pyje, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor.

Lloji i drurëve, që do të mbillen, grafiku i mbjelljeve, mënyra e përmirësimit të kullotës caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila do të ndjekë realizimin e mbjelljeve deri në marrjen në dorëzim me procesverbal, të sipërfaqes së pyllëzuar dhe të përmirësuar, sipas marrëveshjes, që do të lidhë me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


Tabela nr.1

NGASTRAT QË KËRKOHEN PËR HEQJE NGA ZËRI KADASTRAL PYLL

Nr.	Ekonomia pyjore	Ngastra,n/ngastra	Kërkuar ha	Zëri kadastral	Forma e qeverimit	Funksioni	Prona	Propozohet
1	EP Lugina e Fanit të Madh	94/a	5.4	Pyll	Cungishte	Prodhues	Publike	Karrier bazaltesh
2	EP Lugina e Fanit të	94/b	3.9	Pyll	Shkurre	Prodhues	Publike	Karrier bazaltesh

	Madh							
3	EP Lugina e Fanit të Madh	95	5.1	Pyll	Cungishte	Prodhues	Publike	Karrier bazaltesh

HARTA E ZONES SE PROPOZUAR PER PARK INDUSTRIAL
SH.1:5000



VENDIM
Nr.86, datë 27.1.2009

**PËR SHPËRBLIMIN E FAMILJEVE TË FSHATIT LEVRUSHK, KOMUNA QELËZ,
RRETHI PUKË, PËR DËMIN QË U ËSHTË SHKAKTUAR NGA PRANIA E
HIDROCENTRALIT TË KOMANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dëmspërblimin e familjeve të fshatit Levrushk, komuna Qelëz, rrethi Pukë, për dëmin që u është shkaktuar nga prania e hidrocentralit të Komanit, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vlera e dëmspërblimit, në shumën 26 705 454 (njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë, do të shpërndahet nga komuna Qelëz e rrethit Pukë, për kryefamiljarët, sipas tabelës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe komuna Qelëz, e rrethit Pukë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.2

Nr.	Personat e dëmtuar	Lloji i dëmit	Vlera e dëmit, në lekë
1	Kol Zef Ndreu	Shtëpi Agrikulturë Shuma	2 065 951 lekë 1 205 000 lekë 3 270 951 lekë
2	Ndoc Kol Zefi	Shtëpi Agrikulturë Shuma	2 069 957 lekë 1 196 300 lekë 3 266 257 lekë
3	Ndue Zef Ndreu	Shtëpi Agrikulturë Shuma	1 054 545 lekë 477 700 lekë 1 532 245 lekë
4	Gjon Zef Ndreu	Shtëpi Agrikulturë Shuma	1 449 815 lekë 767 300 lekë 2 217 115 lekë
5	Fran Pjetër Toma	Shtëpi Agrikulturë Shuma	3 238 356 lekë 1 421 900 lekë 4 660 256 lekë
6	Agustin Nik Uka	Shtëpi Agrikulturë Shuma	2 427 071 lekë 702 200 lekë 3 129 271 lekë
7	Ndrek Marash Dema	Shtëpi Agrikulturë Shuma	1 011 733 lekë 428 900 lekë 1 440 633 lekë

8	Nikollë Marash Dema	Shtëpi Agrikulturë Shuma	693 343 lekë 725 600 lekë 1 418 943 lekë
9	Gjergj Nik Dema	Shtëpi Agrikulturë Shuma	1 164 171 lekë 286 200 lekë 1 450 371 lekë
10	Pjetër Murrec Dema	Shtëpi Agrikulturë Shuma	1 406 612 lekë 554 200 lekë 1 960 812 lekë
11	Angjelina Martin Zefi	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 528 000 lekë 528 000 lekë
12	Ardian Pjetër Zefi	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 151 300 lekë 151 300 lekë
13	Gëzim Fran Toma	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 554 500 lekë 554 500 lekë
14	Milan Fran Toma	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 447 400 lekë 447 400 lekë
15	Sokol Pjetër Dema	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 152 000 lekë 152 000 lekë
16	Zog Gjergj Dema	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 150 500 lekë 150 500 lekë
17	Bukurie Agustin Uka	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 131 800 lekë 131 800 lekë
18	Çun Murrec Dema	Shtëpi Agrikulturë Shuma	0 lekë 343 100 lekë 343 100 lekë
	Shuma gjithsej 1-18		26 705 454 lekë lekë

VENDIM
Nr.87, datë 27.1.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, QË PREKET NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË**

E FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, që preket nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Fierit, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vlera e shpërblimit, për sipërfaqen 4770 (katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) m², tokë/arë, në masën 4 770 000 (katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Fierit, miratuar në buxhetin e vitit 2008.
3. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Fierit.
5. Afati i përfundimit të punimeve, të objektit “Zgjerimi i varrezave publike”, në bashkinë e Fierit, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
6. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Fierit dhe regjistrimi i ri i pasurisë prej 4 770 (katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) m² tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Fierit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË FIER

Nr.	Emër, mbiemër	Sip në m ²	Çmimi lekë	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Zona kadastrale
1.	Besim Arapi	4770	1 000	4 770 000	Cert.pronësie	2637

VENDIM Nr.89, datë 27.1.2009

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË, PËR NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN PËR MARRËDHËNIET EKONOMIKE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen për marrëdhëniet ekonomike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN MBI
MARRËDHËNIET EKONOMIKE DYPALËSHE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KROACISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Qeveria e Republikës së Kroacisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu quajtur “Palët Kontraktuese”),

në lidhje me Marrëveshjen mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfunduar në Zagreb, më 10 maj 1993 (këtu të quajtur “Marrëveshja”),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Neni 2 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 2

Neni 8 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 10 të Marrëveshjes, paragrafët 3,4,5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 4

Pas nenit 10 të Marrëveshjes, shtohet neni i ri 10 a që lexon si më poshtë:

“Neni 10 a

Që nga data e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, kjo Marrëveshje zbatohet pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga kjo anëtarësi. Për pasojë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen ose interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë mbi detyrimet e vendosura nga Traktati i Bashkimit Europian dhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar në Luksemburg, më 12 qershor 2006.

Për më tepër, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen apo interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë në detyrimet që rrjedhin nga traktatet

ndërkombëtare që do të lidhen, duke zëvendësuar marrëveshjet e mësipërme.”.

Neni 5

Kjo Marrëveshje mbi ndryshimin hyn në fuqi në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, në të cilën Republika e Kroacisë, në kohën e duhur, do të informojë Republikën e Shqipërisë, me kusht që në atë datë Palët Kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Nëse Palët Kontraktuese nuk njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian, kjo Marrëveshje mbi ndryshimet hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilët Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Bërë në _____ më dy kopje origjinale, secila në kroatisht, shqip dhe anglisht, ku të gjithë tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht mbizotëron.

VENDIM

Nr.92, datë 27.1.2009

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË KINOKLUBIT “STUDENTI” NGA “TRAJTIMI I STUDENTËVE, NR.1”, SHA, TIRANË, UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR FAKULTETIN E DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2002 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 82 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të kinoklubit “Studenti” nga “Trajtimi i studentëve, nr.1”, sh.a., Tiranë, Universitetit të Tiranës, për Fakultetin e Drejtësisë.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Trajtimi i studentëve, nr.1”, sh.a., Universiteti i Tiranës dhe zyra për regjistrimin e pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.94, datë 21.1.2009

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2009, PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PËR KRYERJEN E STUDIMIT PËR ULLIRIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit t'i shtohet fondi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, për kryerjen e studimit të plotë, në shkallë vendi, për gjendjen aktuale të kulturës së ullirit dhe për perspektivën e zhvillimit.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

PREVENTIV MBI PËRDORIMIN E FONDIT PËR STUDIMIN E ULLIRIT

Nr.	Aktiviteti	Njësia	Sasia	Çmimi lekë për njësi	Vlera në lekë
1.	Hartografim i të dhënave për rajonizimin	Ha	50 000	100	5 000 000
2.	Analiza të plota agro-pedagogjike	Ha	50 000	60	3 000 000
3.	Grumbullim të dhënash statistikore	Ditë	400	4000	1 600 000
4.	Ekspertizë me ekspert vendas (pagë +shërbime)	Ditë (5 ekspertë x 30 ditë)	150	8000	1 200 000
5.	Ekspertizë me ekspertë të huaj	(1 ekspert)	30	70 000	2 100 000
6.	Shpenzime të tjera (përpunim të dhënash, printime të materialit të studimit etj.)				2 100 000
	TOTALI				15 000 000

VENDIM

Nr.95, datë 27.1.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I RRUGËS DHE I TROTUARËVE, NË RRUGËN “11 NËNTORI”, NË BASHKINË E ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës dhe i trotuarëve, në rrugën “11 Nëntori”, në bashkinë e Elbasanit.

2. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë në sipërfaqe 872 (tetëqind e shtatëdhjetë e dy) m², tokë truall, dhe sipërfaqe ndërtese 898,25 (tetëqind e nëntëdhjetë e tetë presje njëzet e pesë)

m², është 30 714 285,5 (tridhjetë milionë e shtatëqind e katërbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë pesë) lekë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Elbasanit, miratuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Elbasanit.

6. Afati i përfundimit të punimeve, të objektit “Zgjerimi i rrugës dhe trotuarëve, në rrugën “11 Nëntori””, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Elbasanit.

7. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Elbasanit dhe regjistrimi i ri i pasurisë, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E RRUGËS DHE TROTUAREVE NË RRUGËN “11 NËNTORI”, NË BASHKINË ELBASAN

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ² truall	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	Pasuria nr.	Zona kadastrale
1.	Shoqëria “S.A.I.D.E”	872	21 405	18 665 160	11/59	8522

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ² ndërtesë	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	Pasuria nr.	Zona kadastrale
1.	Shoqëria “S.A.I.D.E”	898.25	13 414	12 049 125.5	11/59	8522
	Totali i vlerës në lekë			30 714 285.5		

VENDIM

Nr.96, datë 27.1.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË NË SHKOLLËN E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “UNIVERSITETI “MARIN BARLETI””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti””, me seli në Tiranë, të hapë programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” (MND) në fushat:

- a) Shkenca politike, me profil:
 - i) Liderhip;
 - ii) Administrim publik.
- b) Komunikim, me profil:
 - i) Gazetari ekonomike;
 - ii) Komunikim publik.
- c) Administrim biznesi, me profil:

- i) Financë-kontabilitet;
- ii) Marketing dhe menaxhim operacionesh;
- iii) Shërbime bankare dhe financiare;
- iv) Prona të paluajtshme dhe sigurimi;
- v. Lidërsip dhe menaxhim burimesh njerëzore.

ç) Shkenca juridike, me profil:

- i) E drejtë publike;
- ii) E drejtë e biznesit.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” synojnë arsimim dhe trajnim të mëtëjshëm profesional. Këto programe studimi do të realizohen me, së paku, 60 kredite e me kohëzgjatje normale 1 vit. Në përfundim të këtyre studimeve lëshohet diploma “Master i nivelit të dytë” (MND), në fushat e arsimimit dhe trajnimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti”” që, për çdo program studimi, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, të sigurojë zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

4. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti”” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti”” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.97, datë 27.1.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMI, NË UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, KORÇË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, pika 4, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, në Fakultetin e Bujqësisë, të programit të studimit “Master i nivelit të parë”, në zhvillimin e integruar rural, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP), në profilin “Zhvillim i integruar rural”.

2. Programi i këtij studimi realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, në zhvillimin e integruar rural, me kohë të plotë, në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë 40.

4. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën

jo më pak se 30%, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70%, për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në të.

5. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të përcaktuara nga njësitë kryesore të universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, bëhen publike paraprakisht.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, në programin e studimit “Master i nivelit të parë”, në zhvillimin e integruar rural, do të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

7. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër, të shurdhër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuar, fëmijë romë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, ish-të përndjekur, që do të fitojnë të drejtën ta ndjekin këtë program studimi, do të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi “Master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 3 të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Ky program studimi do të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.99, datë 27.1.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN E PORTIT TË KONTENIERËVE, NË PYLLIN E SODËS, VLORË, SI DHE PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si autoritet kontraktues, për dhënien e koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim), shoqërisë “ZUMAX”, AG, për ndërtimin e portit të kontenierëve, në Pyllin e Sodës, Vlorë.

2. Miratimin e bonusit prej 8 për qind të pikëve për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet kësaj shoqërie.

3. Ngarkohet Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.108, datë 27.1.2009

PËR KRITERET E CILËSIMIT TË SHKELJEVE, ME PASOJA TË RËNDA, NË PYJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 38 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në varësi të dëmit mjedisor, që shkaktojnë, e të pasojave, që sjellin, në pyje, shkeljet, e parashikuara, shprehimisht, në pikën 1 të nenit 38 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, vlerësohen me pasoja të rënda, kur:

a) janë kryer në një zonë pyjore të mbrojtur, sidomos në nënzonat e saj, që janë me status strikt të mbrojtur, duke i nxjerrë ato jashtë funksionit, për të cilin kanë marrë statusin e mbrojtjes;

b) janë kryer në parcelat eksperimentale e studimore të pyjeve, të kullotave e të livadheve, duke bërë të pamundur vazhdimin e eksperimentimit e të studimit shkencor;

c) kanë dëmtuar grumbujt e drurëve dhe të llojeve pyjore, të paracaktuara për konservim, germoplazmë, *in situ* dhe *ex situ*, për grumbullim, përpunim, shpërndarje dhe certifikim të materialit mbjellës;

ç) janë kryer në një pyll mbrojtës, të cilësuar të tillë në planet e mbarështimit, duke e nxjerrë atë jashtë funksionit;

d) kanë shkatërruar një monument pyjor natyror, të miratuar me një akt normativ;

dh) kanë asgjësuar, me prerje, me shkulje, me marrje, individë të llojeve të florës, të rralla, të rrezikuara e që gëzojnë status të veçantë mbrojtjeje;

e) ka shkatërruar cilësitë e një habitati konkret.

2. Shkeljet e tjera, të parashikuara, shprehimisht, në pikën 1 të nenit 38 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, kur nuk përbëjnë asnjërin nga rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, vlerësohen me pasoja të lehta.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore për pyjet dhe kullotat komunale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.109, datë 27.1.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 25 janar 2009, të 3 (tri) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 23 (njëzet e tre) trupa;

- Autokolona e dytë, nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 38 (tridhjetë e tetë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 7 (shtatë) automjete dhe 44 (dyzet e katër) trupa, dhe 1 (një) automjet dhe 2 (dy) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 28 janar 2009, të 3 (tri) autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 27 (njëzet e shtatë) trupa;
- Autokolona e dytë, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) trupa;
- Autokolona e tretë, nga 8 (tetë) automjete dhe 27 (njëzet e shtatë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datën 25 janar 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datën 28 janar 2009, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.110, datë 27.1.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOMJETI DHE DY TRUPAVE
USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 30 janar 2009, të 1 (një) automjeti dhe 2 (dy) trupave ushtarake italiane.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-thanë.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i

përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Automjeti ushtarak italian, së bashku me trupat, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.111, datë 27.1.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE DHE TË NJË AUTOMJETI E DY TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 26 janar 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 3 (tri) automjete dhe 21 (njëzet e një) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 27 janar 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 30 janar 2009, të një automjeti dhe 2 (dy) trupave ushtarake italiane.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 26 janar 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, automjetin dhe trupat, që do të kalojnë në datat 27 dhe 30 janar 2009, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera

pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.112, datë 21.1.2009

**PËR DHËNIEN E LEJES SHOQËRISË “TRANS EUROPEAN ENERGY BV”, SHA, PËR
NDËRTIMIN DHE PËRDOROMIN E TERMINALIT TË GAZIT NATYROR TË
LËNGSHËM (GNL), NË PARKUN ENERGETIK NË BREGDETIN E QARKUT TË FIERIT,
TË GAZSJELLËSIT NËNDETAR SHQIPËRI-ITALI, SI DHE TË RRJETIT TË GAZIT, NË
TERRITORIN SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes shoqërisë “Trans European Energy BV”, sh.a., për ndërtimin dhe përdorimin e terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL), në parkun energjetik në bregdetin e qarkut të Fierit, të gazjellësit nëndetar Shqipëri-Itali, si dhe të rrjetit të gazit, në territorin shqiptar, sipas tekstit të kontratës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.115, datë 2.2.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME,
PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministrinë dhe institucionet qendrore të jetë 1 618 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 3 e vendimit nr.1 703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe të veprimtarive sezonale/të përkohshme, për ministrinë dhe institucionet buxhetore”, nuk do të zbatohet, përjashtimisht, vetëm për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë përcaktimin me hollësi të numrit të punonjësve, sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, sipas profesioneve dhe me afate kohore, brenda kriterëve të vendimit, të përmendur në pikën e mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Grupi	Emri i institucionit	Nr.punonjësve me kontratë
02	Kuvendi i Shqipërisë	11
03	Këshilli i Ministrave	1
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	44
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	190
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	803
10	Ministria e Financave	49
15	Ministria e Punëve të Jashtme	16
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	40
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	83
30	Gjykata Kushtetuese	2
50	INSTAT	378
77	Autoriteti i Konkurrencës	1
	Totali	1618

Grupi	Emri i Institucionit	Nr punonjese	Profesioni	Koha mesatare	Muajt	Totali i fondeve/leke
02	Kuvendi i Shqipërisë	11				13,688,000
	Kuvendi i Shqipërisë	1	Keshilltar pranë Komisionit për Sigurim Kombëtar	8 ore / dite	6 muaj	585,000
	Kuvendi i Shqipërisë	5	Specialiste në ndihmë të Komisioneve të përbërësive dhe hetimore të Kuvendit		6 muaj	12,000,000
	Sherbimi i Botimeve Parlamentare	2	Redaktore pranë Sherbimeve të Botimeve Parlamentare		6 muaj	480,000
	Sherbimi i Botimeve Parlamentare	1	Teknik për shtypshkronjen	4 ore/ dite	6 muaj	120,000
	Kuvendi i Shqipërisë	2	Inzhiner për fotokopje		6 muaj	480,000
03	Keshilli i Ministrave	1				
03	Aparat	1	Teknik shumefishimi	2 ore/ dite	12 muaj	
04	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës	44				
	Aparat	14	Punonjes për Arshiv Protokollin		3 vjet	
	Në Drejtorinë e Mbikqyrjes së Tregut, Sektorin e Regjistrimit të Kolateralit	3	Per Regjistrin e kolateralit		12 muaj	
	Në Drejtorinë e Mbikqyrjes së Tregut, Sektorin e Rregullatve Teknike	2	Per Regjistrin e kolateralit		12 muaj	
	Aparat-Sektorin IT	1	Mirembajtje		12 muaj	
	Aparat	1	Pastruese		12 muaj	
	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit	1	Specialiste IT		12 muaj	
	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit	1	Operatore		12 muaj	
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	4	Specialist për Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore		12 muaj	
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	6	Specialist për Drejtorinë e Inspektimit Metrologjik		12 muaj	
	Inspektorati Qendror Teknik	1	Specialist laborator		12 muaj	
	Inspektorati Qendror Teknik	2	Puntore pastrimi		12 muaj	
	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave	1	Puntore pastrimi		12 muaj	
	Aparat-Sektorin e Sherbimeve të Brendshme	1	Mirembajtje		12 muaj	
	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1	Nepunës shtetbiro- Roje		6 muaj	
	Qendra Kombëtare e Regjistrimit	4	Specialist në Drejtorinë e Regjistrimit		6 muaj	
	ATRAKO	1	Nepunës roje			
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumtorit	190				65,400,000
	Qendrat Transferimit të Tek. Bujqësore	111	Teknik/laborant/topograf	5 ore/ dite	12 muaj	
	Ajensia e Duhan Cigareve	15	Puntore	5 ore/ dite	12 muaj	
	Entin Shtetëror të Faturave	2	Puntore	5 ore/ dite	12 muaj	
	Aparatit e Ministrisë	3	Roje, pastrues si dhe operator terminali	5 ore/ dite	12 muaj	
	Drejtoria Rajonale Bujqësisë, Ushqimit	59	Shoferë roje, pastrues si dhe specialiste	5 ore/ dite	12 muaj	
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	803				
	Aparat	2	Shoferë	6 ore / dite	6 muaj	
	Aparat	1	Korriere	6 ore / dite	6 muaj	
	Akuzni	800	Specialiste	6 ore / dite	6 muaj	
10	Ministria e Financave	49				
	Aparatit e Ministrisë	2	Punonjes Mirembajtje	6 ore / dite	12 muaj	
	Degjet e Thesarit	8	Punonjes Pastrimi	8 ore / dite	12 muaj	
	Aparatit e Ministrisë	1	Roje	8 ore / dite	12 muaj	
	Aparatit e Ministrisë (Drejtoria e Administrimit të dh	1	Punonjes Arkive	8 ore / dite	12 muaj	
	Aparatit e Ministrisë (Dega e Thesant Tirane)	1	Punonjes Arkive	8 ore / dite	4 muaj	
	Aparatit e Ministrisë	1	Punonjes Arkive	8 ore / dite	4 muaj	
	DPPPP	3	Specialiste Analiste		kohe të plote	
	DPPPP	2	Specialiste IT		kohe të plote	
	DPPPP	2	Specialiste- Inspektore		kohe të plote	
	DPPPP	1	Specialiste i Arkives elektronike		kohe të plote	
	Dogana Qafe- Thane, Pogradec	1	Punonjes Mirembajtje			
	Dogana Qafe- Thane, Pogradec	2	Punonjes Pastrim/MIRMBAJTES			
	Dogana Etëbasan	1	Punonjes Mirembajtje			
	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	Punonjes Mirembajtje			
	Dega e Doganës Morine	1	Shofer			
	Dogana Gjakastër	1	Punonjes Mirembajtje			
	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	18	Punonjes Pastrimi	4 ore/ dite	10 muaj	
	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	2	Punonjes ngarkim- shkarkimi	4 ore/ dite	10 muaj	
15	Ministria e Punëve të Jashtme	18				4,059,456
	Drejtoria Konsullore, Legalizimet	10	Preparatorë	6 ore / dite	12 muaj	2,464,425
	Sektorin i Arkiv-Dokumentacionit	4	Punonjes (Studues Arkive)	6 ore / dite	12 muaj	1,140,938
	Sektorin i Sherbimeve dhe Prokurimeve	2	Punonjes Sherbimi	6 ore / dite	12 muaj	454,093
18	Sherbimi Informativ Shtetëror	40				
	Sherbimi Informativ Shtetëror	2	Pastruese		6 muaj	
	Sherbimi Informativ Shtetëror	2	Pastruese		6 muaj	
	Sherbimi Informativ Shtetëror	6	Pastruese	14 dite ne muaj	12 muaj	
	Sherbimi Informativ Shtetëror	6	Kuzhinier		3 muaj	
	Sherbimi Informativ Shtetëror	4	Banquier		4 muaj	
	Sherbimi Informativ Shtetëror	18	Pastruese		5 muaj	
25	Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta	83				
	Zyrat e Punimit, në mënyrë	36	Pastruese	4 ore/ dite	12 muaj	
	Qendrat e Formimit Profesional	10	Pastruese	4 ore/ dite	11 muaj	
	Shtëpitë e Foshnyeve/ Moshuareve	4	Pastruese	4 ore/ dite	12 muaj	
	Shtëpitë e Foshnyeve/ Moshuareve	7	Mjete	4 ore/ dite	12 muaj	
	Shtëpitë e Famjes	2	Pastruese	4 ore/ dite	12 muaj	
	Shtëpitë e Famjes	2	Mjete	4 ore/ dite	12 muaj	
	Zyrat Rajonale	12	Mjete	4 ore/ dite	12 muaj	
	Qendrat e Zhvillimit në mënyrë	5	Pastruese	4 ore/ dite	12 muaj	
		5	Mjete	4 ore/ dite	12 muaj	
38	Gjykata Kushtetuese	3				
	Gjykata Kushtetuese	2	Roje			
88	INSTAT	378				22,487,000
	Instat	107	Anketues strukturore		4 muaj	12,814,000
	Instat	40	Anketues strukturore		3 muaj	3,594,000
	Instat	191	Anketues strukturore		1 muaj	6,079,000
	Instat	40	Të ndryshëm		12 muaj	
77	Autoriteti i Konkurrencës	1				
	Autoriteti i Konkurrencës	1	Punonjes shtetbiro	6 ore / dite	12 muaj	

VENDIM
Nr.145, datë 11.2.2009

**PËR TRANSFERIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA SHTETI NË
“ALBTELECOM”, SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9 e 13 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të neneve 1 e 2, pika 4, të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e paketës së aksioneve të zotëruara nga shteti, prej 16.7683661 për qindësh, të “Albtelecom”, sh.a.-së, Tiranë, nëpërmjet ankandit.
 2. Ky transferim të realizohet me asistencën e një shoqërie këshilluese ndërkombëtare.
 3. Shpenzimet, në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit, për shërbimet, që do të kryejë konsulenti, si dhe për shpenzime të tjera, të nevojshme për realizimin e transferimit të paketës, të mbulohen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, deri në përfundim të procesit të shitjes.
 4. Pas përfundimit të procesit të shitjes, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t’i rimbursohen shpenzimet e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, nga të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, sipas raportit financiar, të paraqitur nga kjo ministri.
 5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.69, datë 29.1.2009

PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË SHOQËRIVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

1. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, procedurat bëhen në përputhje me seksionin V, “Likuidimi” të kreut VI “Dispozita të përbashkëta për të gjitha format e shoqërive”, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
2. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë, dhe ka për objekt mbylljen e llogarive dhe çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci, për efekt likuidimi, miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për identifikimin e asetëve, elemente të pasurisë, që do të likuidohet.
4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, shiten nëpërmjet ankandit, pas publikimit në Buletinin e Njoftimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Njoftimi për shitje bëhet dy herë radhazi, nga data e dërgimit të njoftimit për shitje, si dhe vendoset

edhe në mjediset e shoqërisë e në objektin, që do të shitet. Njoftimi në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet dhe ndiqet nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku do të bëhet edhe shpërndarja e dokumenteve personave të interesuar.

5. Ankandet për shitjen e pasurive të shoqërive tregtare shtetërore në likuidim bëhen në mjediset e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Komisioni i ankandit përbëhet nga jo më pak se 3 veta, të cilët përcaktohen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

7. Bazuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes” në ankandet për shitjen e pasurive të këtyre shoqërive nuk zbatohet, për ish-pronarët, e drejta e parablerjes. Ata marrin pjesë në ankand si të gjithë të tjerët. Në rastet e shpalljes fitues, ish-pronarëve u zbritet vlera e truallit, e njohur dhe e kthyer me vendim të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

8. Gjatë zhvillimit të ankandit mbahet procesverbal, ku evidentohen emrat e anëtarëve të komisionit të ankandit, emrat e konkurruesve në ankand dhe emri i personit të shpallur fitues. Fituesi lidh kontratë për blerjen e objektit, pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, përfshirë dhe TVSH (20%), për asetet, që janë objekt i saj. Pagesa në asnjë rast nuk mund të bëhet me letra me vlerë ose bono privatizimi. Me lidhjen e kontratës, likuidatori bën dorëzimin e objektit, nëpërmjet aktit të dorëzimit.

9. Nëse personi, që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit, nuk paguan brenda 30 ditëve nga data e shpalljes fitues, vlerën e çmimit të arritur në ankand, ai e humbet të drejtën e blerjes, si dhe të marrjes pjesë në ankandin, që do të zhvillohet për rishitjen e këtij objekti. Gjithashtu, pagesa prej 20 për qindësh, e ngurtësuar për pjesëmarrje, nuk kthehet. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

10. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve, të truallit dhe makinerive e pajisjeve është vlera e përcaktuar nga ekspertët vlerësues, të emëruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë, në përputhje me çmimet e tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik, si dhe vlera e mjeteve të xhiros të objektit përkatës.

11. Likuidatori ngre një komision për vlerësimin e mjeteve të xhiros, si më poshtë vijon:

a) Artikujt e grupit “a”, që kanë vlerë tregtimi me qarkullim normal, vlerësohen me çmimin e shitjes me shumicë në treg.

b) Artikujt, që kanë vlerë tregtimi, por me qarkullim të ngadalshëm, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur.

c) Artikujt e grupit “c”, që nuk gjejnë treg shitjeje, vlerësohen me vlerën kontabël, që kanë pasur në kohën kur kanë hyrë në magazinë shumëzuar me koeficientin 0.1.

ç) Për metalet me ngjyrë, si bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaji, nikeli, ari dhe argjendi, vlera fillestare e ankandit, për rastet kur çmimi në treg është më i lartë se vlera kontabël e tyre në bilanc, llogaritet referuar çmimit të bursës së Londrës (LME). Në rast se nuk realizohet shitja me vlerën e llogaritur sipas LME-së, shoqëria cakton vlera të reja, deri në vlerën kontabël të mallit.

12. Raportet e vlerësimit të ekspertëve vlerësues, si dhe raportet e komisionit miratohen para publikimit, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

13. Para publikimit të objektit për shitje, shoqëria kërkon, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, hartën treguese përkatëse.

14. Në rast se nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, objekti publikohet për herë të dytë, me 70 për qind të vlerës së përcaktuar në fillim, duke i shtuar kësaj vlere edhe vlerën e truallit, të përcaktuar nga ekspertët vlerësues, si dhe 50 për qind të vlerës së inventarit ekonomik dhe të mjeteve të xhiros. Nëse edhe me këtë vlerë nuk shitet, atëherë publikohet me vlerë kontabiliteti. Nëse nuk shitet as me vlerën sipas kontabilitetit, atëherë vendos Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

15. Për makineritë dhe pajisjet, që nuk kanë mundur të shiten me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, zbatohen procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi, si shitja e asetëve, arkëtimi i debitorëve, të ardhurat nga qiraja apo edhe fitime të tjera, shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë në likuidim, në

mënyrë proporcionale, në varësi të mjeteve monetare të siguruara. Përfshihen nga ky rregull detyrimet fiskale dhe ato sociale (paga dhe sigurime shoqërore), të cilat do të shlyhen tërësisht. Për kërkesat debitoare, të paarkëtueshme, si në rastin, kur debitorët nuk ekzistojnë, kur kërkesat nuk janë të dokumentuara apo është humbur procesi gjyqësor etj., procedohet, duke i kaluar si shpenzime likuidimi.

17. Likuidatori nuk mund të lidhë kontrata dhe as nuk mund të shesë asete me mirëkuptim, pa autorizimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

18. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

19. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e parashikuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2008 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

20. Anulohen të gjitha miratimet e privatizimit të aseteve të përfshira në kapitalin e shoqërisë që nuk kanë filluar procedurën e përgatitjes së dokumentacionit para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim me vendim gjyqi.

21. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

22. Udhëzimi nr.548, datë 2.8.2007 “Për shoqëritë anonime në likuidim e sipër, me kapital tërësisht shtetëror” i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shfuqizohet .

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
GENC RULI

VENDIM
Nr.3, datë 2.2.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 21.10.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.20/6 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP PREJ 31 DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, të përfaqësuar nga Avokat Artan Hajdari, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga znj. Marsida Xhaferllari, me autorizim.

AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE / NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI), përfaqësuar nga Zëvendës drejtori i përgjithshëm, z.Ferdinand Shehaj.

OBJEKTI: 1. Shpallja si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kartën Europiane të Autonomisë Vendore të neneve 3, pika 8; 4; 5, pika 2; 6; 7; 8; 10; 13; 14,

pika 3; 16; 17; 20, pika 2; 23; 24; 26 dhe 28, pika 2, të ligjit nr.9895, datë 9.6.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 9895, datë 09.06.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 131, germa “a” dhe 134/1, gërma “c”.

Karta Europiane e Autonomisë Vendore, ratifikuar me ligjin nr.8548, datë 11.11.1999.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, nenet 45, 49, 50, dhe 51.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e Kuvendit, të Këshillit të Ministrave dhe të ALUIZNI-t, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.9895, datë 9.6.2008 ka miratuar disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të cilat lidhen kryesisht me funksionin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, si dhe me procedurat e legalizimit të ndërtimeve pa leje.

2. *Një grup prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit*, në cilësinë e subjektit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashtruar përpara Gjykatës Kushtetuese se ndryshimet e bëra me ligjin, objekt shqyrtimi janë antikushtetuese, duke i përqendruar argumentet në këto drejtime kryesore:

- Kompetencat e dhëna nga ligji nr.9895, datë 10.4.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje””, një agjencie të posaçme shtetërore, në varësi të Këshillit të Ministrave, siç është ALUIZNI, ka sjellë centralizmin e gjithë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale, duke cenuar parimin kushtetues të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore.

- Me këtë ligj sanksionohet e drejta e ALUIZNI-t për të vendosur për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe për dhënien e titujve të pronësisë individëve, të cilët posedojnë ndërtimet pa leje, nëpërmjet ushtrimit në mënyrë drejtpërdrejtë të kompetencave të organeve të qeverisjes vendore, në fushën e planifikimit urban dhe të menaxhimit të tokës.

- Dhënia e kompetencave të organeve të qeverisjes vendore një strukture të pushtetit qendror, ndërkohë që ligji organik për qeverisjen vendore i miratuar me një shumicë të cilësuar prej 3/5-ve të anëtarëve të Kuvendit është në fuqi, cenon parimin kushtetues të sigurisë juridike, i evidentuar gjerësisht nga jurisprudenca kushtetuese si pjesë përbërëse e parimit të shtetit të së drejtës, si dhe parimin e hierarkisë së normave juridike. Kompetencat, të cilat organet e qeverisjes vendore i gëzojnë nëpërmjet parashikimeve të këtij ligji organik, nuk mundet që, me një ligj të zakonshëm, t’i kalojnë një organi tjetër, sikurse është ALUIZNI.

3. *Përfaqësuesi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë* ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar se:

- Mënyra e të kuptuarit dhe zbatuarit të ligjit dhe harmonizimi i tij me ligjet e tjera nuk është çështje që i përket kontrollit kushtetues dhe për rrjedhojë, kolizioni ligjor nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.

- Dispozitat e ligjit të ndryshuar nuk u heqin organeve të qeverisjes vendore kompetencat në lidhje me planifikimin e territorit dhe menaxhimin e tokës, për arsye se këto kompetenca jo vetëm që janë të parashikuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", por edhe në rast të ekzistencës së mosmarrëveshjeve së kompetencave ndërmjet pushteteve, organet e qeverisjes vendore do të kishin vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e tyre.

- Ligji nuk cenon autonominë administrative, financiare dhe organizative të njësisive të

qeverisjes vendore, pasi procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje është një proces që nuk parashikohet si kompetencë e njësive të qeverisjes vendore.

- Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë qenë në gjendje të vënë nën kontroll ndërtimet pa leje në territorin e tyre, edhe pse ligji “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” iu ka dhënë kompetenca në fushën e planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës.

- Organizimi dhe funksionimi i ALUIZNI-t si një strukturë e posaçme shtetërore është parashikuar që në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i cili me vendimin nr.35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese nuk është gjetur i papajtueshëm me Kushtetutën.

4. Përfaqësuesi i Këshilli i Ministrave ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar se:

- Ndryshimet ligjore nuk cenojnë parimet kushtetuese të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore. Nxjerrja e ligjit paraqet rëndësi të veçantë me natyrë mbarëkombëtare, por me karakter të përkohshëm, në përgjigje të nevojave sociale të një numri të konsiderueshëm të popullsisë për legalizimin e ndërtimeve pa leje dhe urbanizimin e zonave informate, në respekt edhe të parimit të proporcionalitetit.

- Neni 81 paragrafi 2 i Kushtetutës ka përcaktuar ligjet që miratohen me tre të pestat e gjithë anëtarëve të Kushtetutës, objekt i të cilave janë çështje të rëndësishme të prekura nga Kushtetuta dhe që vendosin shtyllat bazë të organizimit shtetëror. Në listën e nenit 81 pika 2 nuk bën pjesë ligji "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" dhe për rrjedhojë, ligji objekt shqyrtimi nuk ka defekte kushtetuese në drejtim të procedurës së miratimit të tij.

5. Përfaqësuesi i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), në cilësinë e subjektit të interesuar, ka parashtruar se:

- Pretendimi i ngritur nga kërkuesi për cenim të parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore nuk qëndron pasi kanë qenë pamundësia e organeve të pushtetit vendor për të ushtruar përgjegjësitë e tyre, si dhe përmasat që mori informaliteti në ndërtim që e shndërruan zgjidhjen e këtij problemi në një çështje me rëndësi kombëtare, duke e nxjerrë jashtë kuadrit të komunitetit vendor përkatës.

- Ushtrimi i funksioneve që lidhen me planifikimin urban dhe menaxhimin e tokës nga njësitë e qeverisjes vendore del jashtë kuadrit të procesit të legalizimit të ndërtimeve informale, pasi këto ndërtime kanë sjellë në mënyrë të pashmangshme ndryshimin e regjimit të tokës dhe destinacionit të përdorimit të saj, duke tejkaluar kuptimin e kontrollit mbi territorin që ushtrohet nga njësitë e qeverisjes vendore.

- Dispozitat e ligjit të kundërshtuar kanë përmirësuar procedurat e urbanizimit të territoreve pas legalizimit, pasi vendimmarrjet që i përkasin planifikimit urban të territoreve me ndërtime të legalizuara, si “funksione të veta” të njësive të qeverisjes vendore janë zhvendosur në përputhje me etapat e zbatimit të ligjit.

- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” nuk parashikon kompetenca lidhur me kryerjen e procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale dhe nga ky këndvështrim, ALUIZNI nuk ka marrë kompetenca të organeve të qeverisjes vendore. Çdo vendimmarrje pas procesit të legalizimit, lidhur me planifikimin urban apo menaxhimin e tokës, që implikon territoret me ndërtime të legalizuara, nuk sheh si pjesëmarrës këtë strukturë shtetërore.

II

1. Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata) mori paraprakisht në shqyrtim, në seancë plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.9895, datë 9.6.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, u vendos rrëzimi i kërkesës, për arsye të pabazueshmërisë ligjore të argumenteve të parashtruara nga kërkuesi për cenimin e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të ligjit.

2. Lidhur me thelbin e pretendimeve të paraqitura nga kërkuesit dhe subjektet e interesuara, Gjykata vlerëson se kërkesa e iniciuar nga një subjekt i legjitimuar (jo më pak se një e pesta e deputetëve) vjen në bazë të rregullimit kushtetues të parashikuar në nenin 131 shkronja “a” të Kushtetutës dhe që e investon këtë Gjykatë në një proces të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore. Pretendimet e ngritura nga palët në këtë gjykim kushtetues janë përqendruar në

zbatimin që ka gjetur në ligjin, objekt shqyrtimi, parimi kushtetues i decentralizmit të pushtetit dhe i autonomisë vendore dhe për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështje, Gjykata do të bazohet në analizën kushtetuese të këtyre parimeve të rëndësishme.

3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 13 të saj sanksionon se: *“Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore”*. Karta Europiane e Autonomisë Vendore, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8548, datë 11.11.1999, që konsiderohet si pjesë integrale e sistemit të brendshëm juridik, ka përcaktuar koncepte të qarta si për autonominë vendore, ashtu edhe për parimin e subsidiaritetit.

Gjykata, në jurisprudencën e saj kushtetuese, i ka analizuar parimet bazë mbi të cilat e ushtrojnë pushtetin organet e pushtetit qendror dhe të qeverisjes vendore. Qeverisja vendore ngrihet dhe funksionon mbi bazën e parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet nëpërmjet parimit të autonomisë, i cili kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Decentralizmi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të tij qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit *“ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’u takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve”*. Gjykata vlerëson se në një sistem që bazohet mbi vetëqeverisjen, parimi i subsidiaritetit kërkon që problemet të vështrohen si çështje vendore që kanë ndikim në interesin e përgjithshëm. Njësitë vendore vetëqeverisëse nuk mund të pengohen në hapësirën juridiksionale të tyre, nga organet e pushtetit qendror, pasi ato kanë fushën e tyre të veprimtarisë të parashikuar nga Kushtetuta. Vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues që konsiston në ushtrimin nga organet e qeverisjes vendore të punëve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror (neni 113), në ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113, shkronja “b”, “c”, “ç”) (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 21.12.2006).

Gjykata thekson se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka shkuar edhe më tej, kur ka parashikuar funksionet dhe kompetencat bazë të organeve të qeverisjes vendore, si edhe parimet, mbi bazën e të cilave mund t’u kalohen me ligj njësitë të qeverisjes vendore kompetenca të tjera. Pra, Kushtetuta ka përshtatur atë koncept decentralizmi që i përgjigjet më mirë nevojës për një autonomi substanciale të qeverisjes vendore.

Këto përfundime, të cilat rrjedhin nga dispozitat kushtetuese, janë shprehje e autonomisë vendore, që konceptohet si një regjim juridik, në të cilin organet e njësitë vendore veprojnë në pavarësi për zgjidhjen e çështjeve që Kushtetuta dhe ligjet ua kanë lënë atyre në kompetencë. Aspektin e vet më të dukshëm, autonomia e pushtetit vendor e shpreh në ndarjen e kompetencave, e cila ka të bëjë me iniciativën që kanë ose duhet të kenë, në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit, organet e qeverisjes vendore për të vendosur vetë për problemet që hyjnë në juridiksionin e tyre, pa ndërhyrjen e organeve qendrore.

Në jurisprudencën kushtetuese, për çështje që kanë pasur për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore Gjykata ka konkluduar se *“planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor “funksionet e veta”, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre”* (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 21.12.2006). Planifikimi urban përshkruhet si një proces teknik dhe politik që ka të bëjë me mirëqenien e njerëzve, kontrollin dhe përdorimin e tokës, kompozimin e mjedisit urban, si dhe me mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit natyror. Administrimi i tokës përfshin një gamë të gjerë sistemesh dhe procesesh, një pjesë e të cilave është e lidhur ngushtë me zotërimin e tokës, ndërsa menaxhimi përfshin funksione që lidhen me rregullimin, zhvillimin dhe përdorimin e tokës, mbledhjen e të ardhurave prej këtyre funksioneve dhe zgjidhjen e konflikteve që shkaktohen nga marrëdhëniet e pronësisë dhe të përdorimit të tokës. Mbi bazën e këtyre koncepteve kushtetuese, të analizuara nga jurisprudenca kushtetuese, Gjykata konkludon se janë posaçërisht organet e qeverisjes vendore administruese të territorit që ndodhet nën juridiksionin e tyre.

Parë nga ky këndvështrim, Gjykata vlerëson se duke u përfshirë çdo vendim apo veprim që ka ndikim dhe implikon përdorimin e tokës dhe kompozimin urban, në sferën e *“planifikimit urban”* dhe

të “*menaxhimit të tokës*”, nuk mbetet jashtë këtij koncepti procesi i legalizimit të zonave apo ndërtimeve informale. I gjithë procesi i legalizimit, urbanizimit dhe integritit të ndërtimeve pa leje synon sjelljen në një gjendje ligjshmërie të ndërtimeve të kryera në kundërshtim me planet urbanizuese, pa lejen ose në tejkalim të lejes së dhënë prej organeve të qeverisjes vendore, në një territor që menaxhohet në respekt të këtyre planeve, pikërisht prej këtyre organeve.

Ushtrimi i kësaj veprimtarie nga organet e qeverisjes vendore dhe nën autoritetin e tyre është në përputhje dhe me kuptimin kushtetues që i jepet parimit të decentralizimit të pushtetit, i cili, sipas vlerësimit të Gjykatës, përmban në thelbin e tij përcaktimin e misionit parësor për organet e pushtetit vendor për mirëqeverisje, aspekt i rëndësishëm i të cilit është dhe administrimi i territorit nën juridiksionin e vet, ku përfshihen edhe çështjet e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit.

4. Pretendimi kryesor i kërkuarit përqendrohet në mënjanimin që dispozitat e ligjit objekt shqyrtimi, u kanë bërë organeve të qeverisjes vendore nga ushtrimi i kompetencave të tyre kushtetuese e ligjore gjatë procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritit të ndërtimeve informale, dhe kalimin e tyre një agjencie të posaçme shtetërore.

Sipas pretendimit të subjektit të interesuar, ALUIZNI, për shkak të dimensionit masiv të ndërtimeve informale dhe të mungesës së mekanizmave ligjorë rregullues, ndryshimet ligjore synonin saktësimin dhe thjeshtimin e procedurave të parashikuara në ligj. Pamundësia e organeve të pushtetit vendor për të ushtruar përgjegjësitë e tyre, e shndërruan zgjidhjen e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në një çështje me rëndësi kombëtare, duke e nxjerrë jashtë kuadrit të komunitetit vendor përkatës.

Gjykata vlerëson se subjekti i interesuar nuk arriti të argumentojë dhe të përligjë ndërhyrjet e ligjvënësit për mënjanimin e organeve të qeverisjes vendore nga ushtrimi i kompetencave të tyre kushtetuese. Duke i analizuar pretendimet e subjektit të interesuar në frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, Gjykata thekson se është e lejueshme që çështjet me rëndësi kombëtare e strategjike për interesat e vendit të ushtrohen nën autoritetin e pushtetit qendror, i cili është përgjegjës për politikën e zhvillimit ekonomik e politik të vendit, duke u dhënë mundësinë bashkësive vendore “*të gëzojnë brenda mundësive lirinë që ushtrimin e tyre t’ua përshtatin kushteve vendore.*” Megjithatë, do të konsiderohej si cenim i së drejtës për vetëqeverisje të pushtetit vendor, nëse ligjvënësi, duke u hequr kompetenca organeve vendore, do ta dobësonte aq shumë rolin e këtyre saqë ekzistenca ose vetëqeverisja e tyre do të bëheshin të pandjeshme. Njësitë vendore vetëqeverisëse nuk mund të mënjanojnë në ushtrimin e kompetencave nga organet e pushtetit qendror, pasi ato kanë fushën e tyre të veprimtarisë, të parashikuar nga Kushtetuta. Kompetencat, me të cilat ligji pajis organet e qeverisjes vendore, duhet të jenë të tilla që një pjesë e mirë e çështjeve publike të rregullohen sipas parimit të subsidiaritetit, që qëndron në thelb të konceptit të decentralizimit dhe ka një ndikim të madh, veçanërisht përsa i përket efektshmërisë së zgjidhjes së problemeve. Për shkak të karakterit që ka në ndarjen dhe balancimin e pushtetit, vetëqeverisja vendore përbën një ndër bazat për funksionimin e shtetit të së drejtës. Gjykata merr në shqyrtim pikërisht këtë mënyrë të ndarjes së kompetencave nga ligjvënësi, duke e trajtuar problemin jo si vullnet ose dëshirë e pushtetit qendror për t’u transferuar kompetenca organeve të qeverisjes vendore, por si detyrim të tij për të mos cenuar me ligj ato parime kushtetuese që qëndrojnë në themelin e dy shtyllave të qeverisjes vendore, të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore (shih vendimin nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese).

Duke iu referuar çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se rregullimet e parashikuara në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritin e ndërtimeve pa leje”, kanë parashikuar zgjidhje që ndërthurnin gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve informale disa nga kompetencat ndërmjet organeve të pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Kështu, sipas këtij ligji, njësisë së qeverisjes vendore i njihej e drejta të ngrinte strukturat e nevojshme për pranimin, trajtimin dhe kontrollin e vetëdeklarimeve të objekteve pa leje; identifikimi në terren i ndërtimeve pa leje, për të cilat nuk ishte bërë vetëdeklarimi; arkëtimi i pagesave të kryera nga subjekti që legalizon ndërtimin; administrimi i të ardhurave të krijuara dhe monitorimi i përdorimit të tyre; bashkërendimi i punës me këshillin e qarkut, ALUIZNI-n, ministritë e linjës dhe KRRTRSH-në, për mbarëvajtjen dhe ecurinë e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave informale.

Sipas ligjit të sipërcituar, shqyrtimi dhe miratimi i zonave informale, si dhe përcaktimi i destinacionit të objektit sipas vetëdeklarimit apo verifikimit në terren parashikohej si kompetencë e

organeve të qeverisjes vendore. Për objektet/parcelat informale deri në 1 ha, për bllokbanimet dhe ndërtimet pa leje, të veçuara ose në territore të tjera dhe për “shtesa pa leje në ndërtime me leje” vendoste njësia e urbanistikës dhe KRRT-ja përkatëse e njësisë së qeverisjes vendore. Njëkohësisht, të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, tarifat e shërbimit gjatë procedurës së legalizimit në njësinë vendore, si dhe çdo penalitet tjetër që shoqëronte procesin e vetëdeklarimit dhe legalizimit, kalonin për llogari të njësisë vendore ku kryhej vetëdeklarimi dhe destinohej prej saj për përmirësimin e infrastrukturës dhe urbanizimin e territoreve që do të legalizoheshin.

Nga ana e tij, ligji parashikonte që pushteti qendror të ushtronte kompetenca të karakterit të ndihmës, të kontrollit e të vendimmarrjes, për shkak të ndikimit të tij mbi të gjithë vendin dhe të përhapjes që kishte marrë fenomeni i ndërtimeve informale. Krahas disa kompetencave që ligji parashikonte për Këshillin e Ministrave, njëkohësisht pranohej një prezencë konstante e pushtetit qendror në këtë proces nëpërmjet Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), si organi që bashkërendonte punën nëpërmjet organeve qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore. Gjithashtu, sipas nenit 4 dhe 10 të ligjit njihej e drejta ligjore e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale të ushtronte disa nga kompetencat e organeve të qeverisjes vendore, kur konstatohej se këto të fundit nuk arrinin të ushtronin përgjegjësitë e tyre, “për shkak të mungesës së kapaciteteve, neglizhencës ose ndonjë pengese tjetër, për realizimin e procesit për çfarëdo motivi.”

Ndryshimet e kryera në ligjin nr.9895, datë 9.6.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, kanë krijuar një situatë të re përsa u përket kompetencave të organeve të pushtetit qendror dhe atij vendor dhe rolit të tyre respektiv në këtë proces. Gjykata vlerëson se këto ndryshime ligjore kanë minimizuar rolin e organeve të qeverisjes vendore, duke fuqizuar rolin dhe kompetencat e ALUIZNI-it në atë masë, sa në shumë drejtime kanë zhvendosur organet e qeverisjes vendore nga ushtrimi i kompetencave të veta.

Kështu, sipas nenit 3, pika 8 dhe nenit 4, pika 1, shkronja “a” e “ç” dhe pika 2, shkronja “b”, të ligjit objekt shqyrtimi, ALUIZNI, nga një agjenci “që bashkërendonte punët me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore” shndërrohet në “institucionin përgjegjës” për realizimin e procesit të legalizimit, për përgatitjen e regjistrimit fillestar të ndërtimeve informale, për krijimin e përpunimin e informacionit hartografik si dhe për verifikimin e përditësimin në terren të tyre, duke përjashtuar organet e pushtetit vendor nga ushtrimi i disa prej kompetencave të planifikimit urban dhe të menaxhimit të tokës, të cilat Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Karta Europiane e Autonomisë Vendore, si dhe jurisprudenca kushtetuese shqiptare i njohin si kompetenca primare të organeve të qeverisjes vendore.

Me ndryshimin e bërë përmes nenit 5, pika 2 të ligjit objekt shqyrtimi, organet e qeverisjes vendore nuk mund të arkëtojnë pagesat e subjekteve që legalizojnë ndërtimet pa leje. Neni 5, shkronja “c”, sipas së cilës njësia e qeverisjes vendore “arkëton pagesat e kryera nga subjekti që legalizon ndërtimin në përputhje me këtë ligj...” dhe fjalia e fundit e nenit 27, që detyron subjektin kërkues të paguajë “tarifën e shërbimit pranë njësisë së qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje”, janë shfuqizuar nga ligjvënësi duke u kaluar kjo kompetencë ALUIZNI-t. Pra, të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e shërbimit gjatë procedurës së legalizimit në njësinë vendore dhe çdo penalitet tjetër, që shoqëron procesin e vetëdeklarimit dhe legalizimit, sipas nenit 20 pika 2 të ligjit objekt shqyrtimi, “arkëtohen nga ALUIZNI dhe destinohen”. Në këtë kontekst vjen edhe ndryshimi i sanksionuar me nenin 26 të ligjit, sipas të cilit kompetenca për shqyrtimin e kërkesave të paraqitura për legalizim të shtesave dhe për njoftimin e subjekteve për pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe të gjobave i hiqet njësisë së urbanistikës dhe i kalon ALUIZNI-t.

Me këto ndryshime ligjore, Gjykata konkludon se nenet 5, pika 2; 20, pika 2 dhe 26, duke mos lejuar arkëtimin e të ardhurave që do të mund të siguroheshin nga procesi i legalizimit në favor të organeve të qeverisjes vendore, me qëllim përdorimin e tyre për përmirësimin e infrastrukturës dhe të urbanizimit të territoreve që legalizohen, cenojnë rregullimin kushtetues të parashikuar në nenin 113, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit ato “kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.”

Ligji, objekt shqyrtimi, nëpërmjet neneve 6, 7, 8, 10, 14, pika 3, 16, pika 2 e 5 dhe 17, përjashton organet e qeverisjes vendore nga ushtrimi i funksioneve të njohura si të veta, ku përfshihen

domosdoshmërisht edhe çështjet e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit.

Kompetencat e njohura (me nenin 6, shkronja “a” dhe “b” të ligjit të mëparshëm) njësisë të qeverisjes vendore për verifikimin e gjendjes reale të ndërtimeve në vend, për hartimin e hartografisë, si dhe për përditësimin teknik të planvendosjes në terren të ndërtimeve pa leje dhe të territoreve të zëna prej tyre, nëpërmjet shfuqizimit nga ligjvënësi i kalojnë sipas nenit 4 pika 2 shkronja “b”, ALUIZNI - t.

Gjykata vlerëson se, në veçanti, nenet 7, 8 dhe 10 të ligjit (që kanë shfuqizuar nenet 10, 11 dhe 14) kanë ndryshuar edhe procedurën e legalizimit të zonave informale, duke u hequr organeve të qeverisjes vendore kompetencat që lidhen me shqyrtimin e miratimit paraprakisht të zonave informale, emërtimin e përcaktimit e kufirit të tyre, ndryshimin e regjimit të tokës në tokë truall, si dhe ndryshimin e destinacionit të përdorimit në zonë banimi/ekonomike. Sipas dispozitave të sipërcituara, planifikimi i legalizimit të ndërtimeve nuk miratohet nga organet kompetente në fushën e planifikimit urban, të menaxhimit të tokës dhe të kontrollit mbi territorin, por i kalon në mënyrë ekskluzive ALUIZNI-it.

Njëkohësisht, me nenin 14 pika 3 të ligjit, i ka kaluar ALUIZNI-t edhe kompetenca e njohur më parë organeve të qeverisjes vendore për përcaktimin e destinacionit të objektit sipas verifikimit në terren. Sipas kësaj dispozite ligjore, përcaktimi i saktë i destinacionit të objektit është një kompetencë që ndikon drejtpërdrejt në çmimin e shitjes së truallit të objektit dhe që i paraprin procedurës së kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje (neni 14 pika 1). Me kalimin e kësaj kompetence të organeve të qeverisjes vendore një agjencie shtetërore, në varësi të pushtetit ekzekutiv, Gjykata thekson se është shmangur njëkohësisht edhe rregullimi i parashikuar në nenin 32 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, sipas të cilit është këshilli komunal ose bashkiak që “*miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve*”.

Nëpërmjet nenit 17, i cili ka ndryshuar nenin 28 të ligjit, sipas të cilit “*...leja e legalizimit është e barasvlershme me lejen e shfrytëzimit...*”, merret një tjetër funksion i rëndësishëm i organeve të qeverisjes vendore, që lidhet me planifikimin urban dhe i kalon ALUIZNI-t.

Mbi bazën e kësaj analize, Gjykata konkludon se ndryshimet e kryera me nenet 3, pika 8; 4, pika 1, shkronjat “a”, “ç”, dhe pika 2, shkronja “b”; 5, pika 2; 6; 7; 8; 10; 14, pika 3; 16, pika 2, 5; 17; 20, pika 2 dhe 26 të ligjit objekt shqyrtimi, u kanë hequr organeve të qeverisjes vendore kompetencat bazë që lidhen me procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integritit të ndërtimeve pa leje. Këto ndryshime ligjore i kanë zhveshur organet e qeverisjes vendore nga disa prej kompetencave të tyre, që në kuptim të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, si edhe të jurisprudencës kushtetuese, cenojnë parimin e decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet pranuar.

Lidhur me kërkimet e tjera të parashtruara në objektin e kërkesës, Gjykata çmon se kërkuesi nuk arriti të argumentojë papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave të ligjit dhe konkretisht të nenit 4, pika 1, shkronja “b”, “c”, “d”; pika 2, shkronja “a”, “c”, “ç”, e pika 3, si dhe të neneve 16, pika 1, 3, 4; 23; 24 e 28 të ligjit objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, për këto dispozita ligjore të kundërshtuara kërkesa konsiderohet e papabuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Lokale të neneve 3, pika 8; 4, pika 1, shkronjat “a”, “ç”, dhe pika 2, shkronja “b”; 5, pika 2; 6; 7; 8; 10; 14, pika 3; 16, pika 2, 5; 17; 20, pika 2; 26 të ligjit nr.9895, datë 9.6.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”.

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 4, pika 1, shkronja “b”, “c”, “d”; pika 2, shkronja “a”, “c”, “ç”; pika 3, si dhe të neneve 16, pika 1, 3, 4; 23; 24 dhe 28 të ligjit nr.9895, datë 9.6.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Petrit Pllaçi, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Nuk jemi të një mendimi me shumicën për shfuqizimin si jokushtetuese të disa dispozitave të ligjit nr.9895, datë 9.6.2008 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Shumica, në esencë, ka argumentuar se me këto ndryshime janë cenuar disa dispozita të Kushtetutës dhe konkretisht neni 13, i cili sanksionon parimet e decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, si dhe nenet 112 e 113 të Kushtetutës, të cilat rregullojnë çështjen e delegimit të kompetencave – njësisive të qeverisjes vendore dhe funksionet kryesore të organeve të njësisive të qeverisjes vendore.

2. Lidhur me rëndësinë e parimeve të decentralizimit dhe të autonomisë vendore për statusin e qeverisjes vendore në një shtet demokratik të së drejtës, pakica ka të njëjtat vlerësime me shumicën, gjë që është shprehur edhe në vendimet e mëparshme të kësaj gjykate. Këto parime janë detajuar në kuadrin ligjor që rregullon qeverisjen vendore, ku mes të tjerash janë përcaktuar edhe ato funksione të njësisive të qeverisjes vendore, të cilat quhen funksione të veta. Në këto funksione të veta përfshihen edhe *planifikimi urban, menaxhimi i tokës* (neni 10/3/I/g i ligjit “Për qeverisjen vendore”).

3. Në esencë, argumenti i shumicës konsiston në atë se ndryshimet ligjore të kontestuara, duke u marrë organeve të qeverisjes vendore funksionin e mësipërm të *planifikimit e menaxhimit të tokës*, kanë cenuar parimin e autonomisë vendore.

4. Ne mendojmë se argumenti i mësipërm nuk është i bazuar. Është e vërtetë se me ndryshimet ligjore të kundërshtuara janë marrë disa nga funksionet e mësipërme të qeverisjes vendore, por në rastin në shqyrtim një gjë e tillë nuk vjen në kundërshtim me kuadrin juridik në këtë drejtim. Pjesë e këtij kuadri juridik është edhe Karta Europiane e Autonomisë Vendore e ratifikuar më ligjin nr.8548, datë 11.11.1999. Sipas nenit 4 pika 3 të kësaj Karte, “*Ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t’u takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve. Dhënia e një përgjegjësie një autoriteti tjetër duhet të bëhet duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e aftësisë dhe ekonomisë*”.

5. Dispozita e sipërcituar e Kartës lejon dhënien e një përgjegjësie një autoriteti tjetër me kusht, që të mbahen parasysh disa kritere si: *rëndësia, natyra e detyrës, si dhe kërkesat e aftësisë e të ekonomisë*.

6. Ne mendojmë se në rastin në shqyrtim janë plotësuar kërkesat e mësipërme të Kartës për marrjen e një kompetence/funksioni të qeverisjes vendore. Subjektet e interesuara, argumentuan përpara Gjykatës Kushtetuese se ndryshimi ligjor i kundërshtuar ka pasur si qëllim, mes të tjerash, edhe thjeshtimin e procedurave ligjore të legalizimit dhe ka mbajtur parasysh pamundësinë e organeve të qeverisjes vendore për të administruar procesin e legalizimit, përmasat e informalitetit si dhe rëndësinë kombëtare të zgjidhjes së këtij problemi. Ne mendojmë se ligjvënësi ka diskrecion të bëjë vlerësime të kësaj natyre dhe në rastin konkret, ky vlerësim është i balancuar. Nga ana tjetër, ndërtimet pa leje janë një fenomen i jashtëzakonshëm, që nga pikëpamja territoriale prekin pjesë të kufizuara të njësisive të qeverisjes vendore. Marrja e kufizuar e kompetencave, duke ia ngarkuar ALUIZNI-t përmbushjen e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, është e përkohshme. Për pasojë, me përfundimin e procesit të legalizimit, ALUIZNI nuk do të ketë asnjë kompetencë që lidhet me *menaxhimin e tokës*, në kuptim të nenit 10/3/I/g të Ligjit “Për qeverisjen vendore”.

Për sa sipër, ne mendojmë se duke prezumuar kushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar, si parim i vetëpërbajtjes gjyqësore dhe në mungesë të argumenteve të forta për jokushtetutshmërinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese duhet të kishte rrëzuar kërkesën e paraqitur.

Anëtarë: Petrit Pllloçi, Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Vitore Tusha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.2.2009
Doli nga shtypi më 19.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë